



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Projekt-Vendim

Për “Dhënien e Ndhmës Financiare për familjet në nevojë”

Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar , të nenit 8 pika 2 , nenit 9 nënpika 1.1, gërma “b”,ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. Në bazë të kërkesave të bëra nga familjet e mëposhtme dhe verifikimeve të bëra nga punonjësit socialë të Njësisve Administrative të Bashkisë Maliq për gjëndjen social-ekonomike për familjet e mëposhtme i kërkojmë Këshillit të Bashkisë

I. Miratim fondi për familjen e mëposhtme:

Nr	Emri Mbiemri	ID	Nj.Administrative	Shuma /Lekë
1	Çlirim Mersion Molla	G11107018D	Podgorie/Vreshtas	30 000
2	Tushe Shaban Ibra	F56128138D	Fshat Maliq/Maliq	30 000
				60 000

II. Fondet do të përballohen nga Buxheti i vitit 2024, si më poshtë :

Gr.	kap	Kod. Prog.	Llog.eko	Emert.Llogarise	Vlera në lekë
00	05	01110	606	Fondi Social	60 000

III. Bashkëngjitur projekt-vendimit relacionin me gjëndjen Social–Ekonomike të familjes.

Konceptoi:
Miratoi:Dr.Finances dhe Buxhetit
Jurist:

(EmërMbiemër)

E.Petriti
A.Muka
J.Thomo

Nënshkrimi

Data

Dt.26.04.2024
Dt.26.04.2024
Dt.26.04.2024

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTOR I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Maliq, më 26.04.2024

Relacion

Për "Dhënie e Ndhmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr .139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligji nr 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë". Në bazë të verifikimeve të bëra nga punonjësit e Ndhmës Ekonomike Maliq, të Njësive të Bashkisë Maliq për gjendjen social-ekonomike të familjeve të mëposhtme rezultoi se:

1. Z.Çlirim Molla

Familja e Z.Çlirim Mersion Molla përbëhet nga 2 anëtarë, të cilët jetonë në Fshatin Podgorie, Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia Maliq. Ai jeton me bashkëshorten e tij Znj.Fatbardha Molla të cilët jetojnë në kushte të vështira social-ekonomike. Znj.Fatbardha ka edhe probleme shëndetësore dhe vuan prej vitesh nga një sëmundje nervore çrregullim depresiv të shoqëruar me ankth dhe nuk mund të kujdeset për veten e saj.Për arsye se ajo ka mbushur moshën e pensionit,nuk mund të trajtohet me pagesën e aftësisë së kufizuar.E vetmja e ardhur është pensioni minimal i bashkëshortes dhe pagesa e ndihmës ekonomike të cilat nuk i mjaftojnë për mjekimet pasi janë të kushtueshme.Duke mare parasysh kushtet në të cilën jeton familja dhe gjëndjen e rënduar shëndetësore të zonjës Fatbardha kërkon nga Këshilli Bashkiak Maliq një ndihmë financiare për përbalimin e shpenzimeve.

2. Znj.Tushe Ibra

Familja e Znj.Tushe Ibra përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët jetonë në Fshatin Maliq ,Bashkia Maliq. Ata jetojnë në kushte të vështira social-ekonomike dhe banesa ku jetojnë është mjaft e amortizuar dhe e ardhura e vetme është pagesa e ndihmës ekonomike.Duke njohur sitatën e vështirë në të cilën ndodhet familja, është ndihmuar herë pas here me paketa ushqimore. Duke qënë se familja është në kushte të vështira e ka të pa mundur për të përbaluar shpenzimet e nevojshme për këtë arsye i drejtohet Këshillit Bashkiak për ndihmë financiare.

Konceptoi:

E.Petriti

Dt.26.04.2024

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Maliq, më 26.04.2024

RELACION

“MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËFINANCIMIT TË PROJEKTIT TË PËRBASHKËT TË BASHKISË MALIQ DHE KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË , PËR MOSHËN E TRETË.”

Në mbështetje të ligjit nr . 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e shqipërisë”, dhe vkm-së nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, Bashkia Maliq në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut Korçë do të zhvillojë një sërë aktivitete në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për projektin e përbashkët “Një kafe me gjyshin”

Qëllimi kryesor i projektit është të kontribuojë në Ofrimin e shërbimeve ditore në Qendër dhe jashtë saj, në komunitet, për personat e moshës së tretë, me synim përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, drejt një jetese dinjitoze dhe pa pengesa për ta, fuqizimi i familjeve të tyre për krijimin e një komuniteti gjithëpërfshi- rës ku përfituesit e drejtpërdrejtë të projektit do të jenë personat e moshës së tretë në Bashkinë Maliq dhe komuniteti i gjerë.

Aktivitetet kryesore që do të mbështeten nga ky projekt konstatojnë në :

- Ofrimin në Qendër të shërbime ditore për personat e moshës së tretë, si kujdes në shëndet, kujdes në argëtim dhe kalimi i kohës në mënyrë argëtuese, kafe dhe çaj pa pagesë.
- Materialet e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të projektit (kafe, çaj, lojra tavoline etj.) do të mundësohen në formën e mallrave në natyrë nga Këshilli i Qarkut Korçë.
- Bashkëpunimin me OJF dhe shkollat e bashkisë Maliq për vlerësimin e nevojave të personave të moshës së tretë me qëllim nxitjen e vullnetarizmit të rinjve për të ndihmuar gjyshërit e tyre.
- Kontribut në promovimin dhe mbrojtjen e te drejtave të personave të moshës së tretë duke u fokusuar në ndërgjegjësimin e komunitetit për të respektuar këtë moshë si dhe për të treguar vlerat që kjo moshë ka.

Përgj I Sekt. Sh.të kujdesit Shoqëror

(Emër Mbiemër)
E.Petriti

Nënshkrimi

Data


Ot 26.04.2024

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

Adresa: Bulevardi “Rinia”, Maliq, Korçë

www.bashkiamaliq.gov.al

Tel. & Fax: 0861 22026





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Maliq, më 26.04.2024

Projekt-Vendim

"MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËFINANCIMIT TË PROJEKTIT TË PËRBASHKËT TË BASHKISË MALIQ DHE KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË PËR MOSHËN E TRETË."

Në mbështetje të ligjit nr. 139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", dhe vkm-së nr. 518, datë 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar", Bashkia Maliq në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut Korçë do të zhvillojë një sërë aktivitesh në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për projektin e përbashkët "Një kafe me gjyshin"

Kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Maliq:

1. Të miratojë përdorimin e fondit 472 635 lekë të deleguar nga Këshilli i Qarkut në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe projektit "Një kafe me gjyshin" si më poshtë :

- Miratim fondi për "paga dhe sigurime", për një punonjës, me 8 orë pune në ditë (kujdestar salle).

Nr .	Emertimi	Vlera
1	Paga (kujdestar salle , 8 orë pune/ditë)	405000
2	Kontribute sigurimi shëndetësor dhe shoqëror	67635
		472635

2. Ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi mbas miratimit nga ana e institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë .


Konceptoi: Përgj I Sekt. Sh.të kujdesit
Shoqëror

(Emër Mbiemër)
E.Petriti

Nënshkrimi

Data
Dt 26.04.2024

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Maliq, më _____ 2024

PROJEKT –VENDIM

Për

“Mbështetje financiare për ekipin e futbollit Universiteti “Fan.S.Noli” Korçë

Në mbështetje të ligjit 139/2015 date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore " neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak", germa dh, neni 25 " Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese" , ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 32 " Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore ", ligjit nr. 68/2018 "Per financat e vetëqeverisjes vendore" neni 45 "Rishpërndarjen e fondeve buxhetore", ligjit nr. 97/2023 “Per buxhetin e vitit 2024”, mbështetur në vendimin nr.138 dt 26.12.2023 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e buxhetit për vitin 2024 ” Udhëzimin Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1 datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024 " ligji nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar neni 8, pika 3, kërkesës për mbështetje financiare datë 23.04.2024 Universiteti “Fan.S.Noli” Korçë , i kërkoj Këshillit të Bashkisë

1. Të miratojë një fond prej 100,000 lekë për mbështetje financiare për ekipin e futbollit Universiteti “Fan.S.Noli”, i cili do marrë pjesë në Lojrat Europiane Uniuersitare.
2. Paga të kryhet nga buxheti i bashkisë për vitin 2024 me ndryshimin e mëposhtëm

Pakësim

Gr.	Kap.	Kod. Prog.	Llog.Ek.	Objekti	<u>në lekë</u>
00	05	01110	602	Shpenzime për aktivitete	100,000

Shtesë

Gr.	Kap.	Kod. Prog.	Llog.Ek.	Objekti	<u>në lekë</u>
00	05	01110	604	Të tjera transferime korrente	100,000

3. Për zbatim e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashki.
4. Bashkëngjitur keni kërkesën e Universitetit “Fan S.Noli ” Korçë për këtë qëllim.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe zbatohet mbas konfirmimit nga institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë. .

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU